

REPUBLIKA E SHQIPERSISE
SHOQERIA TREGETARE
"LAYO" SH.P.K.
TIRANE

VENDIM NR 5, DATE 28/06/2014
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE
"LAYO" SH.P.K. TIRANE

Ne Tirane, sot ne date 28, muaji Qershor, viti 2014, u mblodh Ortaku i vetem i Shoqerise Tregetare "LAYO" Sh.p.k. Tirane , ne seline e saj mori ne shqyrtimi rendin e dites :

- a) Shqyrtimi i veprimtarise tregetare dhe tregueseve financiare te Shoqerise "LAYO " Sh.p.k. Tirane, per vitin financiar 2013 si dhe ecuria e saj ne te ardhmen;
- b) Zmadhimin e kapitalit themeltar te Shoqerise Tregetare "LAYO " Sh.p.k. Tirane ;

Ortaku i Vetem ,z. Vasil LLAJO, pasi u njoh me rendin e dites

VEREN SE :

Shoqeria Tregetare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, eshte e rregjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit, date 17.11.2009, me ortak te vetem z. Vasil LLAJO dhe administrator z. Vasil LLAJO.

Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregetare dhe tregueseve financiare te shoqerise "LAYO " Sh.p.k. Tirane, Ortaku konstaton se per ecurine me te mire te shoqerise ne te ardhmen, per te patur nje vazhdimesi dhe siguri te veprimtarise, fitimin e vitit ushtrimor 2013 ta kaloj per zmadhim te kapitalit aksionar te kesaj shoqerie per vleren 14,788,563 Leke dhe diferenca per vleren 10,289,099 Leke per shperndarje dividenti ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Ligjit "Per tregaret dhe shoqerite tregetare" , sipas gjendjes se ekspozuar ne bilancin e dates 31.12.2013.

Per keto arsye,Ortaku i Vetem i Shoqerise Tregetare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, pas shqyrtimit te rendit te dites :

VENDOSI :

- Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregetare "LAYO " Sh.p.k. Tirane, per vitin financiar 2013 te mbyllur me date 31.12.2013;
- Zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise tregetare "LAYO" Sh.p.k. Tirane, per vleren 14,788,563 Leke nga fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje me 31.12.2013;
- Shperndarje dividenti per vleren 10,289,099 Leke nga fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje me 31.12.2013;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me fitimet e pa shperndara;
- Depozitimimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit , si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE
"LAYO" SH.P.K TIRANE

VASIL LLAJO



REPUBLIKA E SHQIPERSISE
SHOQERIA TREGETARE
"LAYO" SH.P.K.
TIRANE

VENDIM NR 6, DATE 18/07/2014
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE
"LAYO" SHPK TIRANE

Në Tirane, sot në datën 18, muaji Korrik, viti 2014, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "LAYO" SHPK Tirane, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 15 Korrik 2014 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria Tregtare "LAYO" SHPK Tirane, është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit me date 17.11.2009.

Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie është z. Vasil LLAJO. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 15,211,437 Lekë. Kështu, z. Vasil LLAJO zotëron 100 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 100 (njqind) kuota me vlerën 15,211,437 Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 152,114.37 Lekë;

Me Vendimin Nr. 5, datë 28/06/2014, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "LAYO" Sh.p.k. Tirane, për vitin financiar 2013 të mbyllur me date 31.12.2013;
- Zmadhimin e kapitalit aksionar të shoqërisë tregtare "LAYO" Sh.p.k. Tirane, për vlerën 14,788,563 Leke nga fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje me 31.12.2013;
- Shpërndarje dividendi për vlerën 10,289,099 Leke nga fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje me 31.12.2013;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Institutit të Eksperteve Kontabel të Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksionar me fitimet e pa shpërndara;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 15/07/2014, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 15,211,437 Lekë në 30,000,000 (Tridhjetë milion) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 300,000 (Treqind mijë) Lekë. Pra, vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet ndersa numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit mbetet i pandryshueshëm.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

z. Vasil LLAJO, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 300,000 (Treqind mijë) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e fitimeve të pashperndara për zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë të datës 15 Korrik 2014 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
2. Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të kësaj shoqërie nga 15,211,437 Lekë në 30,000,000 (Tridhjetë milion) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet ndersa numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit mbetet i pandryshueshëm;
4. Vlera nominale e kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar rritet nga 152,114.37 Leke në 300,000 (Treqind mijë) Lekë,
5. z. Vasil LLAJO, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 100 (njqind) kuota (pjesë) kapitali ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 300,000 (Treqind mijë) Lekë;
6. Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit .

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE TREGETARE "LAYO" SH.P.K TIRANE

VASIL LLAJO

